



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

PËR

**PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE DHE NIVELEVE TË TARIFAVE DHE KOSTOVE,
SI DHE MËNYRËN E LLOGARITJES SË TYRE**

Miratuar me Vendim Bordi nr. 155, datë 19.09.2024

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i elementëve dhe niveleve të tarifave dhe kostove që do të zbatohen për fondin e pensionit privat, si dhe mënyra e llogaritjes së tyre.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 155, pika 5, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

**Neni 3
Përkufizimet**

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, këtu e në vijim “Ligji”.

Neni 4

Komisionet dhe tarifat

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat mund të zbatojë komisione vetëm në rastet dhe mënyrat e mëposhtme:
 - a. komision vjetor për administrimin e fondit të pensionit duke zbritur çdo vit një përqindje të caktuar të vlerës neto të aktiveve të administruara;
 - b. komisione të tjera ku mund të përfshihen tarifat dhe kostot që i paguhen depozitarit, kostot e auditimit vjetor, tarifat e licencimit ose tarifa të tjera që i paguhen Autoritetit, e të tjera si:
 - i. komisione ndërmjetësimi;
 - ii. komisione transaksionesh; dhe
 - iii. kosto të nëndepozitarit.
 - c. komision transferimi nëse aktivet transferohen nga anëtarët e një fondi pensioni në një fond të ri pensioni të administruar nga një shoqëri tjetër administruese deri në 0,5% të shumës së transferuar.
2. Shoqëria administruese është e detyruar të deklarojë shumën totale të kostove dhe komisioneve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe t'i publikojë në raportin vjetor të audituar të fondit të pensionit.
3. Të gjitha komisionet e zbatuara nga shoqëria administruese duhet të përfshihen në prospekt, si dhe në kontratën e anëtarësimit të fondit, të listuara në mënyrë të detajuar dhe t'i bëhen të njohura çdokujt që kërkon të bëhet anëtar në fondin e pensionit. Shoqëria administruese duhet të përshkruajë qartë komisionet që do të aplikojë dhe t'i paraqesë ato në formë lehtësisht të kuptueshme nga çdo individ. Kostoja totale vjetore që do t'u zbritet aktiveve të fondit të pensionit, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni nuk mund të kalojë në asnjë rast 2.5 % të vlerës neto të aktiveve të fondit.
4. Çdo rritje e komisioneve të zbatuara nga shoqëria administruese brenda kufirit të përcaktuar më sipër duhet t'u njoftohet anëtarëve të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi. Njoftimi do të kryhet nëpërmjet shërbimit postar ose nëpërmjet postës elektronike për çdo anëtar dhe do të publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë.
5. Brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 102 të ligjit, çdo anëtar i fondit mund të kërkojë ndryshimin e fondit të pensionit, pa paguar komision transferimi.

Neni 5

Llogaritja dhe afati i pagesës së komisionit vjetor për administrimin e fondit të pensionit privat

1. Detyrimet e fondit të pensionit ndaj shoqërisë administruese në lidhje me komisionin e administrimit të fondit, llogariten për çdo ditë kalendarike të vitit financiar¹, sipas formulës:

$$\text{Komisioni i administrimit (në \%)} \times \frac{1}{\text{Ditë kalendarike të vitit financiar}} \times \text{vlera neto e aktiveve të asaj dite}^2$$

2. Detyrimet për komisionin vjetor të administrimit do t'i paguhen shoqërisë administruese të fondit të pensionit një herë në muaj, brenda dhjetë ditëve pune të muajit pasardhës.

Neni 6

Llogaritja dhe afati i pagesës së tarifës së depozitarit të fondit të pensionit privat

1. Detyrimet ndaj depozitarit për kryerjen e veprimtarisë në bazë të kontratës me shkrim të lidhur me shoqërinë administruese, llogariten për çdo ditë kalendarike të vitit financiar, sipas formulës:

$$\text{Tarifa për veprimtarinë e depozitarit (në \%)} \times \frac{1}{\text{Ditë kalendarike të vitit financiar}} \times \text{vlera neto e aktiveve të asaj dite}$$

2. Detyrimet për veprimtarinë e depozitarit do t'i paguhen këtij të fundit një herë në muaj, brenda dhjetë ditëve pune të muajit pasardhës.

Neni 7

¹ Ditë kalendarike të vitit financiar konsiderohen 365 ditë ose 366 ditë në rastin kur është viti i brishtë.

² Llogaritja e komisionit vjetor të administrimit dhe të tarifës së depozitarit do të kryhet mbi të njëjtën vlerë neto të aktiveve të fondit të pensionit të asaj dite.

Llogaritja dhe afatet e pagesës së kostove dhe tarifave të tjera që paguhen nga aktivet e fondit

1. Tarifat e licencimit ose tarifa të tjera që i paguhen Autoritetit do të llogariten dhe paguhen sipas parashikimeve të rregullores nr. 155, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e elementëve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre”, e ndryshuar.
2. Tarifa e auditorit të jashtëm e shprehur në vlerë fikse e përcaktuar në kontratën me shkrim të lidhur me shoqërinë administruese, do të llogaritet në baza ditore duke e pjesëtuar këtë vlerë me ditët kalendarike të vitit financiar dhe do t’i paguhet auditorit të jashtëm sipas marrëveshjes me shkrim ndërmjet palëve.
3. Komisionet e transaksioneve në instrumente financiare, të përcaktuara në kontratën me shkrim ndërmjet shoqërisë administruese dhe ofruesit të shërbimit, do të njihen si detyrim në ditën e tregtimit (*trade date*) dhe do të paguhen në ditën e shlyerjes (*settlement date*).
4. Komisionet e ndërmjetësimit, të përcaktuara në kontratën me shkrim ndërmjet shoqërisë administruese dhe ndërmjetësve, do të njihen si detyrim në ditën e tregtimit (*trade date*) dhe do të paguhen në ditën e shlyerjes (*settlement date*).
5. Komisionet ose tarifat bankare në lidhje me llogarinë e fondit të pensionit, në rast se zbatohen, do të llogariten dhe paguhen sipas kushteve të punës së bankës depozitare ose sipas kushteve të dakordësuara në kontratë me shkrim ndërmjet shoqërisë administruese dhe bankës depozitare.
6. Tarifat në lidhje me veprimtarinë e nëndepozitarit, do të llogariten dhe paguhen sipas kushteve të dakordësuara ndërmjet shoqërisë administruese dhe nën-depozitarit.
7. Kosto dhe tarifa të tjera, të shprehura në vlerë fikse do të llogariten në baza ditore duke pjesëtuar vlerën përkatëse me ditët kalendarike të vitit financiar dhe do të paguhen sipas kushteve të dakordësuara ndërmjet palëve dhe sipas rregulloreve të brendshme të shoqërisë administruese.

Masat administrative

Autoriteti vendos ndaj shoqërisë administruese masën administrative të parashikuar në nenin 199, të ligjit nëse:

1. Ngarkon tarifa që nuk janë parashikuar në nenin 155 të ligjit dhe në këtë rregullore.
2. Nuk deklaron shumën totale të kostove të parashkuara në nenin 155 të ligjit, si tregues të kostove totale dhe nuk e publikon atë në raportet vjetore të audituara, në përputhje me pikën 2 të nenit 4, të kësaj rregulloreje.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në menjëherë.